



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

PROGRAMI PËR KOMPENSIMIN E VIKTIMAVE TË KRIMIT INFORMATA PËR PARASHTRUESIT E KËRKESËS

Pyetjet e shpeshta

Çka është Programi për kompensimin e viktimave të krimit?

Programi për kompensimin e viktimave të krimit financohet nga Buxheti i Republikës së Kosovës. Programi ia mundëson viktimave të veprave të dhunshme të kompensueshme të aplikojnë për kompensim financiar për dëmet si pasojë e veprës penale. Kompensimi nga shteti mund të kërkohej në rastet kur viktimat nuk mund ta realizojnë të drejtën për dëmshpërblim nga i pandehuri apo kompensim nga burimet tjera.

Cilat vepra të dhunshme janë të kompensueshme sipas Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit?

Të gjitha veprat që rezultojnë në :

1. Vdekjen e viktimës
2. Lëndim të rëndë trupor dhe
3. Dëmtim të shëndetit fizik dhe mendor.

Kush janë viktimat e krimit që mund të kompensohen?

Të gjitha viktimat e krimeve të dhunshme që pësojnë dëmet e përmendura më lartë si pasojë e veprës penale. Disa nga kategoritë e viktimave që më së shpeshti aplikojnë në programin e kompensimit janë:

1. Viktimat e dhunës në familje
2. Viktimat e dhunimit dhe abuzimeve seksual (fëmijë, të mitur/a, dhe të rritur)
3. Familjarët e viktimave të vrasjes
4. Viktimat e trafikimit me njerëz

5. Viktimat e sulmit fizik apo tentim vrasjes që kanë pësuar dëmtime të rënda të shëndetit fizik
6. Viktima tjera që iu janë nënshtruar shpërfytyrimit, torturave, abuzimeve fizike, psikike dhe seksuale në mënyrë të vazhdueshme apo kufizimit të lirisë.

Kush tjetër përveç viktimës ka të drejtë të kërkojë kompensim?

1. Anëtarët e familjes apo vartësit të viktimës së ndjerë.
2. Viktimat e rastit (nëse plotësojnë kriteret e caktuara me ligj)

Kur dhe kush mund të ketë qasje të menjëhershme në kompensim?

Vetëm disa kategori të viktimave mund të kenë të drejtën për kompensim të menjëhershëm. Viktimat që mund të kërkojnë kompensim të menjëhershëm pa përfunduar procesi gjyqësor janë:

1. Viktima fëmijë;
2. Viktimat e trafikimit me njerëz;
3. Viktimat e dhunimit;
4. Viktimat e dhunës në familje;
5. Anëtarët e viktimës së ndjerë.

Çka kompensohet nga kompensimi i menjëhershëm?

Qëllimi i kompensimit të menjëhershëm është që viktimave t’iu kompensohen shpenzimet për dëmin e pësuar nga vepra. Në kuadër të kompensimit të menjëhershëm mbulohe këto dëme:

1. Shpenzimet e varrimit (mund të kërkohe edhe me kompensimin e rregullt)
2. Shpenzimet mjekësore dhe hospitalizimit, barnave dhe pajisjeve mjekësore (të dokumentuara)
3. Shpenzime tjera të arsyeshme urgjente.

Çka mbulon kompensimi i rregullt?

Kërkesa për kompensimin e rregullt bëhet pas përfundimit të procedurës së rregullt gjyqësor, respektivisht pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Fillimisht, viktima duhet të kërkojë dëmshpërblimin nga i pandehuri dhe në rast se nuk mund ta realizojë këtë ne procedurën penale përveç në rastet kur viktima e ka pasur të pamundur paraqitjen e kërkesës së tillë.

Në kuadër të kompensimit të rregullt viktimat mund të kërkojnë kompensim nga kategoritë e parapara me ligj varësisht nga dëmi apo dëmet që e kanë pësuar nga vepra penale.

Cilat janë llojet e kompensimeve?

1. Kompensimi për lëndimet fizike apo dëmtimin e shëndetit;
2. kompensimi për dëmtim të shëndetit mendor;

3. kompensimi për vuajtje psikike;
4. kompensimi për vuajtje si pasojë e humbjes së anëtarit të familjes;
5. kompensimi për humbjen e të drejtës në mbajtje;
6. kompensimi për pajisjeve mjekësore të dëmtuara nga vepra penale.

Çka mund të kompensohet në kuadër të kompensimit për lëndimet apo dëmtimin e shëndetit?

Kompensimi sipas këtij lloji jepet për dhimbjet fizike të shkaktuar si pasojë e lëndimet fizike të natyrës së rëndë, dëmtimit të shëndetit, zvogëlimit të aktivitetit jetësor apo sëmundjeve që kanë rezultuar nga vepra penale. Kompensimi bëhet në bazë të shkallës së lëndimit të përcaktuar me Ligj dhe poashtu kompensohen edhe shpenzimet mjekësore të dokumentuara.

Çka dallon kompensimi për dëmtimin e shëndetit mendor nga kompensimi për vuajtjen psikike?

Në kuadër të kompensimit për dëmtimin e shëndetit mendor kompensimi bëhet për shpenzimet e dokumentuara për shërbimet e specialistëve, shpenzimeve të hospitalizimit, medikamenteve dhe shpenzimeve të projektuara për trajtimin e shëndetit mendor. Ndërsa kompensimi për vuajtjen psikike mund të tu jepet vetëm viktimave të kategorive të caktuara të cilat konsiderohen se kanë pësuar traumë në aspektin psikologjik pa dëmtime të rënda fizike si pasojë e veprës penale dhe ky kompensim jepet si një shumë fikse. Të njëjtat viktima mund të kompensohen edhe në kategori tjera përfshirë edhe kompensimin e shëndetit mendor në rast se janë trajtuar dhe kanë shpenzime të dokumentuara.

Kush mund të kualifikohet për kompensimin për vuajtjen psikike?

Kompensimi për vuajtjen psikike si pasojë e veprës penale mund tu jepet:

1. viktimave fëmijë
2. viktimave të dhunës në familje
3. viktimave të trafikimit me njerëz
4. viktimave të dhunimit, sulmit seksual, degradimit të integritetit seksual apo detyrimit në pornografi
5. viktimave tjera që iu janë nënshtruar shpërfytyrimit torturave të vazhdueshme, abuzimeve psikike, seksuale, fizike etj.

Çka mbulon kompensimi për vuajtjen si pasojë e humbjes së anëtarit të familjes?

Kompensimi në këtë kategori mundëson kompensimin e shpenzimeve për trajtimin e shëndetit mendor të anëtarëve të familjes së viktimës së ndjerë. Kompensimi mund të bëhet për shpenzimet e

dokumentuara dhe poashtu për trajtimin e nevojshëm dhe shpenzimet e parapara për sanimin e gjendjes psikologjike.

Çka është kompensimi për humbjen e së drejtës në mbajtje?

Në rastet kur viktimat ka qenë kontribuesi kryesor në mbajtjen e familjes, viktimat ose anëtarët e familjes së viktimës së ndjerë mund të kompensohen deri në një shumë të caktuar, bazuar kategorizimit të dëmtimeve në llojin e kompensimit për dëmtimin e shëndetit. Anëtarët e familjes duhet të dokumentojnë se viktimat e ndjerë ka qenë mbajtësi kryesor financiar i familjes.

A duhet të dokumentohen shpenzimet e varrimit?

Kompensimi për shpenzimet e varrimit bëhet në shumën fikse dhe nuk ka nevojë të dokumentohen. Kompensimi mund të kërkohet si pjesë e kërkesës për kompensim të menjëhershëm ose të rregullt. Shumë fikse ndahet për të gjithë anëtarët e familjes, dhe parashtruesi i kërkesës duhet të sjellë autorizimin e anëtarëve tjerë të familjes për tërheqjen e kompensimit.

Çka mund të kompensohet në kuadër të kompensimit për dëmtimin apo shkatërrimin e pajisjeve mjekësore?

Viktimitat mund të kompensohen për pajisjet mjekësore që janë të domosdoshme për shëndetin e viktimës dhe që janë dëmtuar gjatë veprës penale. Këto pajisje mund të jenë p.sh. syze dioptrie, pajisje dëgjimi, karroca, proteza ortopedike, proteza dentalë etj.

A mund të aplikohet për më shumë se një lloj të kompensimit?

Viktimitat kanë të drejtën për kompensim për të gjitha dëmet e pësuarat me veprën penale. Rrjedhimisht, viktimat mund të aplikojnë për më shumë se një lloj të kompensimit, varësisht nga lloji i dëmit të pësuar. Disa lloje të kompensimit kanë kritere të përcaktuara sipas Ligjit dhe kërkojnë dokumentin të dëmit. Viktimat duhet të këshillohen me kujdes para se të parashtrorjnë kërkesën për kompensim, në mënyrë që të përzgjedhen llojet e kompensimit për të cilat viktimat ka të drejtë të aplikojë.

Çka nuk kompensohet nga Programi i Kompensimit të Viktimave të Krimit?

1. Dëmet që nuk janë në rezultat i veprës së dhunshme
2. Dëmet që plotësisht janë kompensuar nga burimet tjera
3. Veprat penale kundër sigurisë në trafikun publik.
4. Shërbimet e avokatit për plotësimin dhe dorëzimin e kërkesës për kompensim.

Ku mund t'i gjeni formularët për parashtrimin e kërkesës për kompensim?

1. Në Ministri të Drejtësisë (kopje fizike ose elektronike në faqen zyrtare të internetit)

2. Në Zyrën për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave
3. Në Polici
4. Në Zyrat për ndihmë juridike falas

Kush mund të ju ndihmojë në plotësimin e kërkesës për kompensim?

Mbrojtësi i viktimave dhe përfaqësuesit e organizatave qeveritare dhe jo-qeveritare që ofrojnë shërbime ligjore falas mund të ju ndihmojnë në plotësimin e kërkesës. Nuk kompensohet tarifa e avokatit për parashtrimin e kërkesës për kompensim.

Cilat janë dokumentet e nevojshme që duhet bashkëngjitur kërkesës për kompensim?

1. Dokumentin e policisë për veprën penale për kërkesën për kompensim të menjëhershëm
2. Vendimi i plotfuqishëm i gjykatës për kërkesën për kompensimin e rregullt
3. Dokumenti i identifikimit
4. Raportet mjekësore
5. Dëshmitë e shpenzimeve
6. Autorizime dhe çertifikata
7. Dokumente tjera shtesë që kërkohen sipas nevojës.

Cilat janë afatet për dorëzim të kërkesës për kompensim?

Kërkesat për kompensim të menjëhershëm mund të dorëzohen brenda afatit prej 3 vjetësh nga raportimi i veprës penale ose nga pranimi i aktgjykimit të plotfuqishëm.

Ku duhet ta dorëzoni kërkesën për kompensim?

1. Kërkesën duhet ta dorëzoni drejtpërdrejt ose përmes postës në Ministri të Drejtësisë, në Prishtinë.
2. Kërkesën mund ta dorëzoni edhe në formë elektronike në e-mail adresën e komisionit kkvk.md@rks-gov.net

Kush merr dhe kur merret vendimi lidhur me kërkesën?

Komisioni për Kompensimin e Viktimave të Krimit merr vendim brenda 90 ditëve nga dita e pranimit të kërkesës së plotë.

Si informoheni për vendimin e Komisionit?

Divizioni për mbështetjen e viktimave të krimit ju njofton për vendimin e Komisionit, në email, përmes telefonit apo postës.

A mund të ankoheni ndaj vendimit të Komisionit?

Në rast të pakënaqësisë ndaj vendimit të Komisionit, ju mund të iniconi konflikt administrativ në pajtim me ligjet në fuqi.

Ku mund të merrni informata shtesë?

Ju mund të informoheni në detaje lidhur me kërkesën tuaj në informatat e kontaktit më poshtë:

Komisioni për Kompensimin e Viktimave të Krimet

Ministria e Drejtësisë

Departamenti për Drejtësi Tranzicionale dhe Mbështetjen e Viktimave të Krimet

Ish-ndërtesa e Rilindjes, Prishtinë 10 000

ueb-faqja: <https://md.rks-gov.net/>

E-mail adresa: kkvk.md@rks-gov.net

Numrat e telefonit: +383 38 200 67 145; +383 38 200 67 144; +383 44 911 029; +383 44 148 775